



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 100 datë 04.12.2025

**PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR BASHKINË
PËRMET PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligjin 57/2020 "Për pyjet"; Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore, pyjore", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM Nr.285 datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj", VKM nr.784 datë 09.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar administrimin e përdorimit të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të MZSH-së", VKM nr.467, dt.31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", e pamë të arsyeshme që të kishte një ndryshim dhe në tarifën vendore që duhet të mbledhet nga njësitë administrative për taksën e kullotjes së bagëtivë, VKM nr.783 date 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet, sipas dokumentit bashkëngjitur.
- II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, si dhe të gjitha Drejtoritë e tjera pranë Bashkisë Përmet, Njësitë Administrative etj.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar) dhe i shtrin efektet financiare në datën 01.01.2026.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

